



Thirrje për Aplikime

Shumica Digjitale: Gratë në Wikipedia

Punëtori: Kapërcimi i Hendekut Gjinor në Botën Digjitale

Jeni të interesuar për edukimin digjital dhe përfaqësimin gjinor në hapësirat online? Bashkohuni me punëtorinë tonë për të shkruar përmbajtje për gratë dhe aktivizmin e grave në Wikipedia dhe kontribuoni në zvogëlimin e hendekut gjinor në botën digjitale!

E bazuar në **Platformën Shumica Digjitale**, kjo punëtori trajton pabarazinë gjinore në Wikipedia. Hulumtimet tregojnë se **gratë përbëjnë më pak se 10% të redaktorëve të Wikipedia-s**, duke çuar në përfaqësim të kufizuar dhe paragjykim në përmbajtjen e saj. Dukshmëria dhe qasja në informacion për gratë në Wikipedia mbetet e kufizuar. Kjo punëtori synon të ndryshojë këtë realitet duke pajisur pjesëmarrësit me aftësi për të shkruar dhe redaktuar përmbajtje në Wikipedia nga një perspektivë gjinore.

 **Vendndodhja:** Universiteti i Prishtinës

 **Datat:** 5 & 6 Mars 2025

 **Ora:** 10:00 – 13:30

 **Gjuha:** Shqip

Ftojme të gjithë të interesuarit nga Kosova të aplikojnë! Nuk kërkohet përvojë e mëparshme në redaktimin e Wikipedia-s vetëm dëshira për të kontribuar në një hapësirë digjitale më gjithëpërfshirëse.

 **Aplikoni këtu:** <https://forms.gle/b5Zc9XZi6DpUSFeu8>

Mirëpresim aplikimet e juaja deri më 27 shkurt 2025!

Për çdo pyetje, mos hezitoni të na kontaktoni. Presim me kënaqësi aplikimin tuaj!